



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:232942

Datë: 17.07.2024

Numri i dokumentit: 05948809

C.nr.959/21

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri me bashkëpunëtorin profesional Liman Javori, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.H.nga fshati G.-Komuna e Malishevës, të cilin me autorizim e përfaqëson Agron Kryeziu avokat në Malishevë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë rruga “P.J”, me objekt kontesti: ”Dëmshpërblim”, vlera e kontestit 500.00 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 17.07.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET** se paditësi F.H.nga fshati G.-Komuna e Malishevës, **e ka tërhequr padinë** që identifikohet në këtë gjykatë me shenjën C.nr.959/21 e datës 23.09.2021, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti “Dëmshpërblim”.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi F.H.nga fshati G.-Komuna e Malishevës, përmes të autorizuarit të tij Agron Kryeziu avokat në Malishevë, me datë 23.09.2021 në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti “Dëmshpërblim”, vlera e kontestit 500.00 euro.

Lidhur me këtë, gjykata me datë 13.06.2024 ka nxjerrë aktvendim për përgjigje në padi dhe të njëjtin ia ka dërguar të paditurës, e cila me datë 05.07.2024 ka kthyer përgjigje duke theksuar se ka arritur marrëveshje jashtë gjyqësore me paditësin dhe i ka përmbushur të gjitha obligimet duke ia bashkangjitur parashtrësës edhe transferin bankar mbi pagesat, andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta hedhë poshtë si të palejueshme.

I autorizuari i paditësit, me datë 10.07.2024 e ka dorëzuar në këtë gjykatë parashtrësën për tërheqjen e padisë në këtë çështje juridiko-kontestimore, duke e njoftuar gjykatën se me të paditurën kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit material dhe jo material, andaj ka theksuar se paditësi e tërheqë padinë e parashtruar pranë kësaj gjykate.

Gjykata vlerëson se konform nenit 3 par.1 të LPK-së, i cili i referohet parimit të disponibilitetit, palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat e parashtruara në procedurë kontestimore, përfshirë edhe tërheqjen e padisë, veprim ky i përcaktuar me dispozitën nga neni 261 par.2 të LPK-së, ku parashihet se: *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklaronet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*.

Bazuar në faktin se paditësi e ka tërhequr padinë pasi i padituri e ka pranuar padinë dhe pasi ka paraqitur përgjigje në padi, atëherë gjykata vlerëson se janë përmbushur prezumimet procedurale për të vepruar konform dispozitës nga neni 261 par.3 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Andaj, në një gjendje të këtillë, Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 par. 2 dhe 3 lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.959/21, datë 17.07.2024

Gj y q t a r i
Petrit Curri

Udhëzim juridik: *Kundër këtij Aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa konform nenit 261 par. 4 të LPK-së.*